

UDHËZIM
Nr. 16, datë 15.6.2022

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 31, DATË 26.12.2013,
“PËR EMETIMIN NGA QEVERIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË
OBLIGACIONEVE NË FORMË REGJISTRIMI”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe të neneve 5 dhe 20, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 31, datë 26.12.2013, “Për emetimin nga qeveria e Republikës së Shqipërisë të obligacioneve në formë regjistrimi”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime, si më poshtë:

Neni 1

Pas pikës 4, të nenit 1, shtohet pika 5 me përmbajtje si vijon:

“5. Blerja mbrapsht (procedura e riblerjes) është metoda që përdoret për një menaxhim aktiv të portofolit të borxhit publik, me qëllim mitigimin e riskut të rifinancimit dhe përmirësimin e profilit të borxhit të brendshëm.”.

Neni 2

Pika 1, e nenit 3, ndryshohet si vijon:

“1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si përfaqësuese e qeverisë së Republikës së Shqipërisë në emetimin e titujve shtetërorë, për çdo tremujor, jo më vonë se 15 ditë para fillimit të tremujorit përkatës, publikon kalendarin e emetimit të llojeve të ndryshme të obligacioneve. Në këtë kalendar, përcaktohet frekuenca e zhvillimit të ankandeve, datat dhe shumat indikative të emetimit sipas afateve të maturimit të obligacioneve. Në rastin e riblerjes, përcaktohet:

- a) ISIN që do të blihet mbrapsht (riblerje);
- b) Shuma që pritët të blihet para kohe;
- c) Data e ankandit;
- d) Data e shlyerjes.”.

Neni 3

Pas pikës 1, të nenit 5, shtohet pika 1.1 me përmbajtje si vijon:

“1/1. Për ankandet e riblerjes, njoftimi përmban elementet e mëposhtme:

- a) Numrin unik (ISIN) të titullit që do të blihet mbrapsht;
- b) Shumën që do të blihet mbrapsht;
- c) Datën e shlyerjes së ankandit;
- d) Tipin e ankandit (uniformë apo më shumë çmime).”.

Neni 4

Pas pikës 1, të nenit 12, shtohet pika 1.1 me përmbajtje si vijon:

“1/1. Për ankandet e riblerjes, Ministria vendos për nivelin e normës së interesit (*yield-it*) të pranuar në bazë të të cilit përcaktohen fituesit e ankandit të riblerjes (shitësit e obligacioneve).”.

Neni 5

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Delina Ibrahimaj

Ishte	Bëhet (ndryshimet)
Neni 3, pika 1 Kalendari i emitimit të Obligacioneve 1. Ministria e Financave si përfaqësuese e qeverisë së Republikës së Shqipërisë në emitimin e titujve shtetëror, për çdo tremujor, jo më vonë se 15 ditë para fillimit të tremujorit përkatës, publikon kalendarin e emitimit të llojeve të ndryshme të obligacioneve. Në këtë kalendar, përcaktohet frekuenca e zhvillimit të ankandeve, datat dhe shumat indikative të emitimit sipas afateve të maturimit të obligacioneve.	Neni 1/1, pika 5 shtohet Blerja mbrapsht (procedura e riblerjes) është metoda që përdoret për një menaxhim aktiv të portofolit të borxhit publik, me qëllim mitigimin e riskut të rifinancimit dhe përmirësimin e profilit të borxhit të brendshëm. Neni 3, pika 1 Kalendari i emitimit të obligacioneve 1. Ministria e Financave si përfaqësuese e qeverisë së Republikës së Shqipërisë në emitimin e titujve shtetëror, për çdo tremujor, jo më vonë se 15 ditë para fillimit të tremujorit përkatës, publikon kalendarin e emitimit të llojeve të ndryshme të obligacioneve. Në këtë kalendar, përcaktohet frekuenca e zhvillimit të ankandeve, datat dhe shumat indikative të emitimit sipas afateve të maturimit të obligacioneve. Në rastin e riblerjes, përcaktohet: a) ISIN që do të blihet mbrapsht (riblerje); b) Shuma që pritët të tërhiqet para kohe; c) Data e ankandit; d) Data e shlyerjes. Neni 5, pika 1/1 shtohet 1/1. Për ankandet e riblerjes, njoftimi përmban elementet e mëposhtme: a) Numrin unik (ISIN) të titullit që do të blihet mbrapsht; b) Shumën që do të blihet mbrapsht; c) Datën e shlyerjes së ankandit; d) Tipi i ankandit (uniformë apo më shumë

	çmime). Neni 12, pika 1/1 shtohet 1/1. Për ankandet e riblerjes, Ministria vendos për nivelin e normës së interesit (<i>yield-it</i>) të pranuar në bazë të të cilit përcaktohen fituesit e ankandit të riblerjes (shitësit e obligacioneve).
--	---